



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL. Anr.246/2025

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët Hajriz Hoti, kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Afrim Fazliut, kandidat nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Podujevë, paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 20.10.2025, merr këtë,

V E N D I M

Refuzohet e pabazuar ankesa parashtuar nga Afrim Fazliu, kandidat nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Podujevë, ZL.Anr.246/2025, e datës 17.10.2025, e paraqitur kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive gjatë ditës së votimit për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës të mbajtura me datën 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

Me datë 17.10.2025, PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Afrim Fazliu, kandidat nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Podujevë, në të cilën kërkon rinumërimin e votave në pesë qendra të votimit pas qe beson qe i është tjetërsuar votat e tij dhe ju kanë kaluar kandidatëve tjerë. I njëjti thekson se vëzhguesit e tij i kanë paraqitur dje, janë betuar që e kanë votuar atë numrin 191 PDK Afrim Fazliu 13. Parashtruesi i ankesës kërkon që të rinumërohen këto qendra si në vijim:1802-SHML "Aleksander Gjjuvani" në Podujevë, 1802/01, 1802/02, 1802/03, SHFMU "Naim Frashëri" në Podujevë 1804/01, 1804/02, SHML Ekonomike "Isa Boletini" në Podujevë 1805/01, 1805/02, 1805/03, 1805/04, 1805/05, 1805/06, 1805/07, 1805/08, SHFMU "Xheladin Rekaliu" në Podujevë 1806/01, 1806/02, 1806/03, 1806/04, 1806/05, 1806/06, 1806/07, SHFMU "Ibrahim Rugova", 1807/01, 1807/02, 1807/03, 1807/04, 1807/05, 1807/06, 1807/07, 1807/08, 1807/09. Parashtruesi i ankesës ka përmendur emrat e disa personave për të cilët pretendon se janë dëshmitar.

KQZ në përgjigjen në ankesë thekson se në lidhje me kërkesën e juaj jep sqarimet, përgjigjet si më poshtë: Bazuar në nenin 101 të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës (LZP), Rregulloren Zgjedhore Nr,16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN)J Procedura e Veprimit në Qendrën Komunale të Numërimit për Zgjedhjet

Lokale 2025, e miratuar më 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedura e detajuar lidhur me procesin e numërimit në QKN. Rezultatet preliminare nga vendvotimet mund korrigjohen në Qendrën Komunale të Numërimit, në përputhje me paragrafin 3 të nenit 14 të Rregullores Zgjedhore Nr. 16/2024 për Qendrat Komunale të Numërimit (QKN). Bazuar në Rregullën Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet e Zgjedhore nenin 9 paragrafi 1 thekson se: Në rast të mospërputhjes së rezultateve, KQZ-ja mund të urdhëroj rinumërimin e votave të cilit do VV ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Pala ankuese, nuk e ka precizuar mjaftueshëm gjendjen faktike, nuk ka dhënë prova të mjaftueshme në lidhje me pretendimet e tij, duke përfshirë këtu: Formularët e Rezultateve të Subjekteve Politike, libri i votimit, deklaratat e KVV etj. Po ashtu mbështetja në pohime të qytetarëve (votuesve) nuk është argumentuar, për më tepër, duhet theksuar, se vota është e fshehur, dhe publikimi i saj, shpërfaq vullnetin, e çdo votuesi në fletëvotim që është në kundërshtim me parimin kushtetues të fshehtësisë së votës, dhe në asnjë mënyrë nuk mund të merret si fakt provues. Palët ka bërë ankesë ndaj rezultateve mirëpo këto rezultate ende nuk janë publikuar, andaj në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LZP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesnin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesën dhe përgjigjen në ankesë vëren se ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës, përgjigjes në ankesë të KQZ-së, vlerësoj se pretendimet në ankesën e Afrim Fazliu, kandidat nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, dega Podujevë, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë se *“sepse besoj që më është tjetërsuar votat, votat e mia ju kanë kaluar kandidatëve tjerë”*, paneli nuk ka arritur që të vërtetoj se ka pasur shkelje apo parregullsi për të cilat pala ankuese pretendon me ankesën e tij, kjo pasi që paraqitësi i ankesës nuk i ka bashkëngjitur ankesës asnjë provë dhe nuk ka arritur me ankesë të argumentoj pretendimet e tij se i mungojnë votat, ndërsa pretendime e theksuara më shumë janë supozime se sa thënie të dokumentuara në fakte dhe në prova konkrete. Paneli po ashtu edhe nga përgjigja e ofruar nga KQZ-ja shihet se nuk ka pasur asnjë nga parregullsitë për të cilat pretendohen me ankesë.

Andaj Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të përgjithësuara, të pa argumentuara dhe të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesë, parashtuesi i ankesës nuk ka arritur që të vërtetoj me asnjë provë të vetme se me këto veprime ka pasur shkelje të dispozitave ligjore të Ligjit për Zgjedhje apo të Rregullave Zgjedhore të KQZ-së.

Paneli, vlerësoi se ankesa është e pabazuar dhe e pa argumentuar, pasi që parashtuesi i ankesës nuk ka bashkëngjitur asnjë dëshmi si formularët e rezultateve të subjekteve politike dhe të kandidatëve, librin e votimit, deklaratat e KVV apo dokumente të tjera, apo mbështetjen-në pohimet të qytetarëve (votuesve) nuk është e argumentuar e me te cilën do të vërtetoheshin këto pretendime.

Duke marrë parasysh të lartpërmendurat, Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve të tij, nuk ka ofruar dëshmi të qarta dhe bindëse, edhe pse në bazë të nenit 117 par.3 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, barra e të provuarit bie mbi ankuesin, në të cilin në përcaktohet se “Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nënin 117 paragrafi 3, lidhur me nenin 118 paragrafi 1 të Ligjin Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
ZL.Anr.246/2025 datë 20.10.2025

Kryesues i Panelit
Hajriz Hoti



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.